




|   |                      |
|---|----------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                      |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                      |
| Dep. DPK  | Nr. Prot. 01/2306/13 |
| Nr. i ftau  | 03                   |
| Broj stranica   | 31-07-2013           |
| Nr. pages   | 2 faze               |
| PRISHTINE   |                      |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **24.07.2013**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

*I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-467/13 për z. Tomor Qela-Anëtar i Bordit të Drejtoreshave të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi", për shkak se z. Qela tashmë nuk është Anëtar i këtij Bordi e as zyrtari i lartë që ushtron ndonjë funksion publik.*

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-467-13, për Zyrtarin e lartë, z. Tomor Qela – Anëtar i Bordit të Drejtoreshave të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" sh.a., dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-467/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Qela së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-1636/13), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Qela është deklaruar se i ka skaduar mandati i të qenurit Anëtar i Bordit të Drejtoreshave të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" sh.a. në Prishtinë, për faktin se atje ka pasur këtë pozicion vetëm në mandat të caktuar (me rotacion) si përfaqësues i Komunës së Drenasit.

Ndërkohë, pas kërkesës tonë, ztr. Qela na ka dërguar edhe me shkrim një Shkresë zyrtare – Vërtetim, (DPK/DPKI-03-2189/13) në të cilën Sekretari i Kompanisë Rajonale "Pastrimi" na ka njoftuar se Tomor Qela ka qenë Anëtar i Bordit të kësaj Kompanie që nga data 10.11.2010 duke

ushtruar këtë detyrë me rotacion gjatë tri periudhave, e së fundi prej datës 01.12.2012 deri 31.05.2013.

Po ashtu në këtë shkresë zyrtare jemi njoftuar se që nga data 01.06.2013 ztr.Qela nuk e ushtron më detyrën e Anëtarit të Bordit të Kompanisë "Pastrimi" dhe natyrisht nuk merr as pagë (honorar) nga kjo kompani.

Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

\_\_\_\_\_  
/ Hasan Preteni /

